



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës (KMAL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- B1 Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare ishin nënvlerësuar për 944,848€, si rezultat i diferencës ndërmjet regjistrit detal analitik të llogarive të arkëtueshme me aneksin përkatës të prezantuar në PVF. Po ashtu, në 19 raste tek llogaritë e arkëtueshme të taksës për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 129,229€, si dhe në tre (3) raste të qirave nga shfrytëzimi i pronës komunale në vlerë 35,726€, mungonin dokumentet burimore të llogarive të arkëtueshme;
- B2 Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 664,254€, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime gjyqësore/përmbartimore, si dhe pagesave të tjera të realizuara nga Komuna;
- B3 Pasuritë e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar ishin të keqdeklaruar, si rezultat i mosregjistrimit të investimeve kapitale dhe investimeve në vijim në vlerë prej 1,717,728€, si dhe mbivlerësimit të pasurive jokapitale për 271,691€;
- B4 Detyrimet kontingjente të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin keqdeklaruar për 266,031€, si rezultat i mos përditësimit të regjistrit pas pagesës së detyrimeve, si dhe mos përfshirjes së plotë të detyrimeve në raste të caktuara.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Malishevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- B5 Në 19 raste të pagesave në vlerë 805,212€, ishin bërë ndryshime në ndarjet buxhetore të projekteve kapitale pa miratim nga Kuvendi Komunal.
- B6 Në 27 raste të obligimeve në vlerë totale prej 767,498€, ishin evidentuar vonesa në pagesë që varionin nga 5 deri 150 ditë pas afatit të përcaktuar ligjor;
- B7 Në tre rast në vlerë prej 555,942€, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme financiare;
- B8 Në një rast me vlerë prej 30,000€, Komuna kishte lidhur Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik, duke iu shmangur procedurave të prokurimit;
- B9 Komuna kishte iniciuar procedura të prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit;
- B10 Në një kontratë kornizë me çmime për njësi, realizimi i kategorive kishte devijuar nga peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit;
- B11 Komuna kishte angazhuar shërbime të veçanta për pozita që i përkasin funksioneve të rregullta të punës;
- B12 Në një rast, ishte dhënë në shfrytëzim prona komunale me tarifa jo në përputhje me Rregulloren komunale;
- B13 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme, në përputhje me kërkesat ligjore.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Malishevës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Malishevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Malishevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Malishevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar janë: prezantimi jo i drejtë i shpenzimeve, nënvlerësimi i pasurive dhe llogarive të arkëtueshme, si dhe keq deklarim të detyrimeve kotigjente. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi tek ridestinimi i projekteve kapitale, hyrje në obligime kontraktuale pa mbulesë, vonesa në pagesën e faturave, anashkalim i procedurave të prokurimit, tejkalim i vlerës së kontratave, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, si dhe iniciimin i procedurave të prokurimit pa projekte ekzekutive.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpалosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 19 rekomandime, prej tyre 18 të përsëritura dhe një pjesërisht të përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Nënvlerësim dhe mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme

##### Gjetja

Rregullorja MF-01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 6, përcakton se Organizatat buxhetore mbajnë evidenca të sakta kontabël, të plota, të përditësuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informacionet financiare dhe informacionet e tjera jofinanciare. Gjithashtu, organizatat buxhetore duhet të sigurojnë dokumentacion dhe evidenca mbështetëse për vërtetimin e saktësisë dhe vlefshmërisë së llogarive të arkëtueshme të raportuara në PVF.

Bazuar në rishikimin analitik të Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës, kemi vërejtur një nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme prej 944,848€. Në nenin 16 të PVF-ve "Raporti për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë", ishte shpалosur vlera prej 3,258,376€, ndërsa sipas regjistrimit detal analitik të llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë, vlera ishte 4,203,224€. Diferenca ka rezultuar për shkak se në PVF ishte përfshirë vetëm ngarkesa bazë e tatimit në pronë, ndërsa nuk ishin përfshirë interesi dhe ndëshkimet.

Gjithashtu, në 19 raste të llogarive të arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 129,229€, si dhe në tre (3) raste të qirave nga shfrytëzimi i pronës komunale, në vlerë prej 35,726€, Komuna nuk kishte dokumentacion burimor për të mbështetur vlerat e prezantuara dhe të drejtën e saj për arkëtimin e këtyre shumave.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të kontrollit për harmonizimin e regjistrave analitikë të llogarive të arkëtueshme me vlerat e raportuara në PVF, si dhe mungesës së verifikimit dhe ruajtjes së dokumentacionit burimor për të mbështetur vlefshmërinë dhe arkëtueshmërinë e këtyre llogarive.

**Ndikimi**

Nënvlerësimi i regjistrit dhe mungesa e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme, ndikon në raportim jo të saktë dhe jo të plotë të tyre në PVF. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit burimor mund të vështirësojë ndërmarrjen e veprimeve ligjore për inkasimin e këtyre shumave.

**Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë regjistra të saktë, të plotë dhe të harmonizuar për llogaritë e arkëtueshme, si dhe ruajnë dokumentacionin burimor që mbështet vlerat e prezantuara në PVF dhe të drejtën e Komunës për arkëtimin e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B2 - Keq klasifikim i shpenzimeve në kategoritë ekonomike****Gjetja**

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga “Rezerva” me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarrimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore (pika 3, paragrafi i fundit), përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Nga mostrat e testuara, kemi identifikuar keq klasifikime në 19 pagesa në vlerë totale 664,254€. Detajet e rasteve të identifikuara janë si në vijim:

- Komuna nuk kishte planifikuar fonde rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbarrimore, në përputhje me kërkesat ligjore. Si pasojë, në 16 pagesa në vlerë totale prej 591,720€, obligimet e krijuara nga këto vendime janë mbuluar nga kategori të tjera buxhetore, duke rezultuar në klasifikim të shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate.  
Në kuadër të këtyre pagesave, vendime gjyqësore në vlerë 481,311€, të cilat ndërlidheshin me obligime nga kontrata kolektive (paga jubilarë dhe shujta), ishin ekzekutuar nga Thesari, prej të cilave 308,999€ nga kategoria e investimeve kapitale dhe 172,312€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, 110,409€ ishin ekzekutuar nga investimet kapitale për shpenzime të natyrës së mallrave dhe shërbimeve.
- Gjithashtu, nga mostrat e testuara janë identifikuar tre (3) raste të pagesave në vlerë 72,534€ të realizuara nga Komuna, të cilat nuk lidhen me vendime gjyqësore, por që po ashtu janë klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate.  
Konkretisht, pagesa në vlerë 44,989€ ishin ekzekutuar nga investimet kapitale për shpenzime të mallrave dhe shërbimeve, ndërsa pagesa në vlerë 27,545€ për shpenzime kapitale ishin ekzekutuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së ndarjes së fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, dobësive në kontrollet e brendshme gjatë planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën me kohë të obligimeve.

**Ndikimi**

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin ose nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke rezultuar në prezantim jo të saktë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

**Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndër marrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B3 - Nënvlërësim i pasurive kapitale dhe jo kapitale në regjistrat e pasurive****Gjetja**

Rregullorja Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Gjithashtu, Rregullorja MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 19 lidhur me shpalosjen e pasurive jo financiare në PVF, kërkon që vlerat e raportuara në pasqyrat financiare të jenë të sakta dhe në përputhje me regjistrat zyrtarë të pasurive.

Nga analiza e Pasqyrave Vjetore Financiare dhe regjistrave të pasurisë, kemi identifikuar mospërputhje që kanë rezultuar në nënvlerësim të pasurive për 1,053,963, si në vijim:

- Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrin e pasurive në SIMFK, investime kapitale në vlerë 1,582,210€, të financuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, të bartura në pronësi të Komunës së Malishevës sipas marrëveshjes së datës 01.12.2025.
- Në dy raste të investimeve në vijim, të paguara gjatë vitit 2025 për ndërtimin trotuareve dhe blerje të pajisjeve, në vlerë 135,518€, pasuritë nuk ishin regjistruar në SIMFK.
- Bazuar në rishikimin analitik të PVF-ve, kemi identifikuar mbivlerësim të pasurive jokapitale në vlerë prej 271,691€. Në nenin 19.3.2 të PVF-ve "Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€", ishte shpalosur vlera 647,577€, ndërsa sipas regjistrat detal analitik të pasurive (Excel) vlera ishte 375,886€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos koordinimit adekuat ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e pasurisë dhe atyre të financave, si dhe mangësive në zbatimin e kontrolleve të brendshme për regjistrimin me kohë dhe të plotë të pasurive.

**Ndikimi**

Mospërputhjet ndërmjet regjistrave të pasurisë dhe PVF-ve, si dhe mos regjistrimi i investimeve në vijim në regjistrin e SIMFK-së rezultojnë në prezantim jo të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në pasqyrat vjetore

financiare.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë harmonizimin periodik të regjistrave të pasurisë ndërmjet regjistrit analitik dhe PVF-ve, si dhe të forcojë kontrollet e brendshme për regjistrim të plotë, të saktë dhe në kohë të pasurive në sistemet përkatëse.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente**

**Gjetja** Rregullorja e MF Nr.01/2017, për Raportim Vjetor Financiar, neni 6, përcakton se organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Ndërsa neni 18, i rregullores së njëjtë përcakton se organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në janë të obliguara të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Detyrimet kontingjente në PFV ishin keq deklaruar për 266,031€, si rezultat i gabimeve në vijim:

- Në pesë (5) raste detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 259,488€, si rezultat i gabimeve teknike apo mos shlyerjes së detyrimeve në regjistër, pavarësisht që pagesat ishin realizuar;
- Në dy (2) raste, detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 6,543€, për shkak të mos përfshirjes së të gjitha shpenzimeve që lidhen me lëndët përkatëse.

Këto çështje kanë ndodhur si rezultat i mos përditësimit të rregullt dhe jo të plotë të regjistrit të detyrimeve kontingjente, si dhe mungesës së koordinimit ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj të financave.

**Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare. Si rrjedhojë, përdoruesit e PVF-ve mund të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontingjente.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë përditësimin e rregullt dhe të plotë të regjistrit të detyrimeve kontingjente, si dhe forcimin e koordinimit ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave, në mënyrë që detyrimet të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PVF.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B5 - Ndryshimet në ndarjet buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

#### Gjetja

Ligji Nr. 08-L-332 për ndarjet buxhetore për vitin 2025, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Gjatë ekzaminimit të pagesave të projekteve kapitale, kemi identifikuar 19<sup>6</sup> raste në vlerë totale prej 805,212€, ku fondet janë marrë nga projekte të tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime (rialokime) janë realizuar pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal për ridestinimin e fondeve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme gjatë procesit të rialokimit të fondeve buxhetore.

#### Ndikimi

Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrjen lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike. Po ashtu, mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese, duke rrezikuar financimin e mjaftueshëm të tyre.

#### Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që çdo ndryshim në ndarjet buxhetore të projekteve kapitale, të aprovohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal, në përputhje me kërkesat ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B6 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve

#### Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 39.1 parasheh që: "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në 27 raste, në vlerë totale prej 767,498€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor të përcaktuar. Vonesat në pagesë varionin nga 5 deri në 120 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Këto vonesa kanë ndodhur si rezultat i mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare, për shkak planifikimit jo adekuat të obligimeve kontraktuale, si dhe pagesave të pa planifikuara të realizuara përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore.

**Ndikimi** Vonesat në pagesën e faturave rrisin rrezikun e krijimit të kostove shtesë për komunën, përfshirë shpenzime nga procedurat gjyqësore dhe përmbarimore.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë planifikim dhe menaxhim më efektiv të mjeteve financiare në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i tyre.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B7 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme**

**Gjetja** Ligji Nr. 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 37.1, përcakton se organizata buxhetore nuk mund të ndërmarrë obligime që tejkalojnë fondet e ndara. Ndërsa, Ligji për Prokurimin Publik, neni 9.2 dhe 9.3, kërkon që para inicimit të prokurimit të sigurohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve kontraktuale.”.

Gjatë auditimit kemi identifikuar tre (3) raste ku Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme të parapara në Ligjin e Buxhetit dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, si në vijim:

- Kontrata “Ndërtimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit të lumit me strukturën përcjellëse nga ura në qendër deri tek tranziti” në vlerë 146,450€, ishte nënshkruar pa pasur mjete të buxhetuara me Ligjin e Buxhetit për vitin 2025 për këtë projekt, duke rezultuar në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme;
- Kontrata “Renovimi i objekteve të institucioneve arsimore në komunën e Malishevës” në vlerë 259,492€, ishte nënshkruar pa pasur mjete të buxhetuara për këtë projekt për vitin 2025, duke rezultuar me obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme;
- Kontrata kornizë “Rrëtimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore në territorin e komunë së Malishevës” në vlerë 150,000€, ishte nënshkruar pa pasur mjete të buxhetuara për këtë projekt për vitin 2025, duke rezultuar me obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së mbajtësve të buxhetit për respektimin e limiteve të ndarjeve buxhetore të projekteve të caktuara me rastin e nënshkrimit të kontratave.

**Ndikimi** Hyrja në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme rrit rrezikun e krijimit të detyrimeve të papaguara dhe kostove shtesë, përfshirë shpenzime nga procedurat përmbarimore, duke ndikuar negativisht në buxhetin e vitit aktual dhe viteve vijuese.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurohet që para inicimit dhe nënshkrimit të kontratave, të verifikohet ekzistenca e fondeve të mjaftueshme buxhetore për projektet përkatëse, në përputhje me ligjin e buxhetit dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B8 - Shmangie e procedurave të prokurimit****Gjetja**

Ligji Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, neni 3.5, përcakton rastet kur ky ligj nuk zbatohet, përkatësisht vetëm kur financimi kushtëzohet nga marrëveshje ndërkombëtare që kërkojnë procedura të tjera të prokurimit. Ndërsa, Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 21.2, përcakton kategoritë e shpenzimeve që nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit.

Komuna kishte realizuar pagesë në vlerë prej 30,000€ në emër të anëtarësimit, bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Jo Qeveritare "Agjensioni i Zhvillimit Rajonal - Jugor (AZHR-Jug)" për periudhën 01.06.2024-31.05.2025. Sipas dokumentacionit, AZHR-jug është themeluar si shoqatë nga disa komuna me qëllim zhvillimin ekonomik rajonal.

Qëllimi i marrëveshjes ishte zhvillimi socio-ekonomik i Komunës së Malishevës dhe ngritja e kapaciteteve për hartimin e projekteve. Megjithatë, marrëveshja nuk përmban obligime të qarta dhe të matshme për palën përfituese, përderisa Komuna nuk posedon dokumentacion mbështetës për shërbimet e pranuar apo aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Si rrjedhojë, kjo pagesë, ndonëse e klasifikuar si shpenzim i anëtarësimit, në përmbajtje përfshin elemente të angazhimit të shërbimeve, pa specifikim të qartë të obligimeve dhe pa dokumentim të përfitimeve, duke krijuar rrezik për shmangie të procedurave të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të mjaftueshme të brendshme dhe moszbatimit të rregullave të prokurimit publik.

**Ndikimi**

Pagesat e realizuara përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit për shërbime, pa procedura të prokurimit dhe pa përcaktim të qartë të përfitimeve dëmtojnë transparencën dhe konkurrencën, si dhe rrisin rrezikun e pagesave të parregullta dhe joefikase, duke ndikuar negativisht në arritjen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi B8**

Kryetari duhet të sigurojë që për çdo shërbim të nevojshëm të zbatohen procedurat e prokurimit publik, ndërsa marrëveshjet e bashkëpunimit të përdoren vetëm në rastet kur nuk përfshijnë elemente të prokurimit dhe kur përfitimi për Komunën është i qartë, i matshëm dhe i dokumentuar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B9 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv****Gjetja**

Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 19.17 ndër të tjera përcakton se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv, i cili në mënyrë të detyrueshme duhet t'i bashkëngjitet specifikave teknike (gjithashtu në formë elektronike) si pjesë e dosjes së tenderit. Asnjë autoritet kontraktues nuk lejohet të publikojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e detajuar të projektit.

Komuna kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontratë për projektin “Ndërtimi i rrugës tek Ujëvara e Mirushës, Komuna Malishevë” në vlerë 546,164€, pa u hartuar paraprakisht projekti ekzekutiv, por vetëm duke u bazuar në specifikacionet teknike.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së verifikimit të mjaftueshëm nga njësitë kërkuese dhe Zyra e Prokurimit lidhur me sigurimin e projektit ekzekutiv para inicimit të procedurës së prokurimit.

**Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim jo efektiv të kontratave për punë si dhe të shkaktojë shpenzime të paparashikuara apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi B9** Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive nga njësit kërkuese dhe Zyra e Prokurimit, në mënyrë që, para inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, të sigurohet hartimi i projekteve ekzekutive në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat e projektit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B10 - Peshim joreal i kategorive dhe devijim në realizimin e kontratës**

**Gjetja** Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 17.35, parasheh se në kontratat me çmime për njësi, kur sasisë nuk dihen paraprakisht, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë peshët për secilën kategori bazuar në rëndësinë e tyre, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi i drejtë i ofertave. Peshimi duhet të reflektojë rëndësinë reale të kategorive dhe realizimi nuk duhet të devijojë në mënyrë të konsiderueshme nga peshët e përcaktuara.

Në dosjen e tenderit për kontratën kornizë “Rregullimi dhe mirëmbajtja verore-dimërore e rrugëve dhe lumenjve në territorin e Komunës së Malishevës”, me vlerë të parashikuar 1,470,000€, janë përcaktuar gjashtë kategori me peshë përkatëse (40%, 7%, 3%, 20%, 10% dhe 20%).

Gjatë analizës së realizimit të kontratës, kemi vërejtur devijim të konsiderueshëm ndërmjet peshëve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe realizimit faktik të kategorive të kontratës. Konkretisht, kategoria “Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve”, e planifikuar me 40%, është realizuar në nivel 57%, ku vlera e realizuar ishte 584,086€ nga 1,004,091€ sa ishte vlera totale e realizimit të kontratës.

Kjo tregon se peshimi fillestar nuk është bazuar në vlerësim të saktë sipas nevojave reale.

Kjo çështje ka ndodhur si rezultat i përcaktimit jo real të peshëve në fazën e planifikimit, të cilat nuk kanë reflektuar nevojat reale të Komunës, si dhe mungesës së mekanizmave për rishikim dhe kontroll gjatë realizimit të kontratës.

**Ndikimi** Devijimi ndërmjet peshëve të përcaktuara dhe realizimit të kontratës tregon dobësi në planifikimin e nevojave dhe mund të ndikojë në vlerësim jo të saktë të ofertave gjatë fazës së tenderimit, duke krijuar rrezik për mos efikasitet në shfrytëzimin e fondeve publike.

**Rekomandimi B10** Kryetari duhet të sigurojë që, gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit për kontratat me çmime për njësi, njësia kërkuese dhe Zyra e Prokurimit të bëjnë vlerësim më të saktë të nevojave, në mënyrë që peshimi i kategorive të reflektojë rëndësinë reale të tyre dhe të minimizohen devijimet gjatë realizimit të kontratës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B11 - Angazhimi i shërbimeve të veçanta për pozita të rregullta të punës

**Gjetja** Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57, paragrafi 3, përcakton se shërbimet e veçanta duhet të përdoren vetëm për shërbime profesionale që nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rregullta të rekrutimit dhe që nuk mund të mbulohen nga stafi ekzistues i autoritetit kontraktues.

Gjatë vitit 2025, komuna kishte angazhuar konsulentë për ofrimin e shërbimeve të veçanta përmes procedurave të prokurimit për pozita, si: zyrtar në Drejtorinë për Kulturë, zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë, zyrtar për lektorim, si dhe zyrtar për komunikim me publikun. Këto angazhime përfaqësojnë funksione të rregullta të vendeve të punës, të cilat nuk përbëjnë shërbime të veçanta profesionale dhe, si të tilla, duhet të mbulohen përmes procedurave të rregullta të rekrutimit. Kontratat e angazhimit për këto shërbime ishin lidhur për periudhë njëvjeçare, duke treguar se bëhej fjalë për nevoja të vazhdueshme dhe jo për shërbime specifike apo të përkohshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak se gjatë planifikimit të nevojave për staf dhe inicimit të procedurave të prokurimit, nuk ishte bërë vlerësimi i duhur nëse shërbimet e kërkuara përfaqësonin funksione të rregullta të vendeve të punës apo shërbime të veçanta profesionale.

**Ndikimi** Angazhimi i shërbimeve të veçanta për pozita që i përkasin funksioneve të rregullta të punës mund të ndikojë në mos aplikim të qëndrueshëm të praktikave të rekrutimit. Po ashtu, kjo praktikë rrit rrezikun për përdorim joefikas të fondeve publike dhe menaxhim jo të duhur të burimeve njerëzore.

**Rekomandimi B11** Kryetari duhet të sigurojë që angazhimi për shërbime të veçanta të bëhet vetëm në rastet kur këto shërbime janë të natyrës profesionale dhe nuk mund të mbulohen nga stafi ekzistues i Komunës, ndërsa funksionet që i përkasin pozitave të rregullta të punës të mbulohen përmes procedurave të rregullta të rekrutimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B12 - Aplikim jo i duhur i tarifave për shfrytëzimin e pasurisë komunale

**Gjetja** Rregullorja komunale nr. 02/31 për tatimet, tarifat dhe gjobat komunale për vitin 2024, neni 15, paragrafi 2, përcakton se shfrytëzimi i përkohshëm i pasurisë komunale me konstruksione të përhershme për banim ose veprimtari afariste, tarifa është 4€ për m<sup>2</sup>.

Në një rast të dhënies në shfrytëzim të përkohshëm (afatshkurtër) të pasurisë komunale, përkatësisht pishina në Banjën e Malishevës me

sipërfaqe prej 5,147 m<sup>2</sup>, Komuna kishte aplikuar tarifë vjetore prej 3€ për m<sup>2</sup>, në kundërshtim me tarifën e përcaktuar prej 4€. Si rrjedhojë, Komuna ka inkasuar më pak të hyra në vlerë prej 5,147€. Kjo, pasi që ishte aplikuar tarifën për shfrytëzimin e kioskave dhe objekteve të montueshme, ndërkohë që pishina dhe objekti përkatës përbëjnë ndërtime të përhershme dhe duhet të trajtohen sipas tarifave përkatëse për këtë kategori.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së verifikimit nga zyrtarët përgjegjës për zbatimin e tarifës përkatëse sipas kategorisë së pasurisë komunale, para lidhjes së kontratës për dhënie në shfrytëzim.

**Ndikimi** Aplikimi i tarifave më të ulëta se sa ato të përcaktuara me rregulloren e komunës, rezulton në inkasim më të ulët të të hyrave, duke ndikuar negativisht në buxhetin e komunës dhe në realizimin e objektivave të saj.

**Rekomandimi B12** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në aplikimin e tarifave tepër shfrytëzimin e pronës komunale, duke respektuar normat e përcaktuara me rregulloren komunale.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B13 - Dështimi në inspektimin e 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë**

**Gjetja** Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15, paragrafi 2, parasheh se veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte arritur të përmbushë kërkesën ligjore, për inspektimin e së paku 20% të objekteve, pasi kishte inspektuar vetëm 450 objekte, që përbëjnë rreth 3% të numrit të përgjithshëm të objekteve në territorin e saj.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme për realizimin e aktiviteteve inspektuese, si dhe mungesës së një plani efektiv për përmbushjen e kërkesës ligjore përkatëse.

**Ndikimi** Mosrealizimi i inspektimeve në nivelin e kërkuar rezulton në informata jo të plota dhe jo të përditësuara për pronat e tatueshme, duke ndikuar në vlerësim jo të saktë të tatimit në pronë dhe në inkasim më të ulët të të hyrave vetanake.

**Rekomandimi B13** Kryetari duhet të sigurojë hartimin dhe zbatimin e një plani efektiv për aktivitetet inspektuese, duke forcuar kapacitetet dhe monitorimin, në mënyrë që të arrihet niveli minimal prej 20% i inspektimeve vjetore, në përputhje me kërkesat ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në Komunën e Malishevës është 12,543,236€, ndërsa realizimi ishte 12,474,149€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,372 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,434.

#### Çështja C1 - Mangësi në përpilimin e testimit me shkrim në procedurat e rekrutimit

**Gjetja** Udhëzimi administrativ i MFPT nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkurseve në sektorin publik, i cili ka shfuqizuar Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017, përcakton rregullat dhe standardet minimale të procedurave të konkurrimit në institucionet e sektorit publik të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 14, paragrafi 4, testi duhet të përmbajë së paku tridhjetë (30) pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe së paku një (1) ese, ku çdo pyetje duhet të përmbajë pikë të caktuara.

Në procedurat e rekrutimit të zhvilluara nga Drejtoria e Shëndetësisë, bazuar në konkurset e datave 16.01.2025 dhe 05.06.2025 për angazhimin e nëntë (9) personave, testimi me shkrim është zhvilluar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, i cili ishte shfuqizuar në mars të vitit 2024, me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ të MFPT nr. 01/2024.

Në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit të ri, testi me shkrim përmbante 20 pyetje, apo pesë më pak se minimumi i kërkuar, si dhe nuk përmbushej plotësisht strukturën e kërkuar e testimit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosinformimit të mjaftueshëm lidhur me ndryshimet në legjislacionin në fuqi, si dhe mungesës së kontrolleve të brendshme në zbatimin e procedurave të rekrutimit.

**Ndikimi** Zbatimi i procedurave të shfuqizuara dhe mosrespektimi i kërkesave të reja ligjore mund të ndikojë në vlerësim jo të plotë dhe jo të standardizuar të kandidatëve, duke cenuar ligjshmërinë dhe besueshmërinë e procesit të rekrutimit.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të siguroj që të gjitha procedurat e rekrutimit të zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përmes forcimit të kontrollit dhe informimit të zyrtarëve përgjegjës, në mënyrë që të sigurohet ligjshmëria dhe standardizimi i procesit të rekrutimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,726,284€, prej tyre cilave gjatë vitit 2025 ishin shpenzuar 6,717,680€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën rrugore, rregullimin e lumenjve, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, si dhe furnizime me makineri, pajisje mjekësore dhe pajisje tjera.

### Çështja B14 - Vonesa në realizim të projekteve

**Gjetja** Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, nenit 70.23, përcakton se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik e realizon kontratën në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara. Po ashtu, kushtet e veçanta të kontratës (neni 9) përcaktojnë përfundimin e punimeve brenda afatit të kontraktuar.

Gjatë auditimit kemi vërejtur vonesa në realizimin e kontratave në vijim:

- Kontrata “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, faza e parë, Bubel-Lubizhde” në vlerë 1,260,344€, e lidhur më 15.03.2023, me afat përfundimi më 10.11.2025, deri në fund të vitit 2025 ishte realizuar vetëm 23% apo 289,880€;
- Kontrata “Ndërtimi i Objektivit të shkollës fillore dhe sallës së edukatës fizike në fshatin Turjak” në vlerë 991,730€, e lidhur më 19.01.2023, me afat përfundimi më 29.08.2024, deri në fund të vitit 2025 ishte realizuar 73% apo 725,747€;
- Kontrata “Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës Lot 2” në vlerë 274,400€, e lidhur më 23.11.2022, me afat përfundimi më 30.09.2024, deri në fund të vitit 2025 ishte realizuar 68% apo 187,668€;
- Kontrata “Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës” në vlerë 596,486€, e lidhur më 15.11.2022, me afat përfundimi më 01.07.2024, deri në fund të vitit 2024 ishte realizuar 66% apo 396,691€;
- Kontrata për "Ndërtimi e kanalizimit të ujërave fekal në fshatin Mirushe Komuna e Malishevës" me vlerë 336,501€ e nënshkruar më 30/11/2022, me afat përfundimi më 31.07.2023, ishte përfunduar më 13.03.2026;
- Kontrata "Punimi i murit mbrojtës dhe rregullimi i rreth rrotullimit në fshatin Pagarushë në Malishevë" në vlerë 74,106€ ishte nënshkruar me 12.09.2024, me afat përfundimi 60 dite, deri më 03.06.2025 ishte realizuar 85% apo 63,079€.

Këto vonesa kanë ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për pagesën e operatoreve ekonomik, si pasojë e hyrjes në obligime pa mbulesë të plotë buxhetore.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të planifikuara, dhe në vonesën e vënies në funksion të projekteve në shërbim të qytetarëve, duke ndikuar në efikasitetin e shfrytëzimit të fondeve publike.

**Rekomandimi B14** Kryetari duhet të sigurojë që projektet kapitale të planifikohen dhe buxhetohen në përputhje me dinamikën e realizimit të kontratave, duke garantuar fonde të mjaftueshme për pagesat, në mënyrë që të shmangen

vonesat në realizimin e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

#### Çështja B15 - Mospërdorim i modulit në e-prokurim për menaxhim e kontratave dhe vlerësimin e performances

##### Gjetja

Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton se: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualet për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24 të kësaj rregulloreje, menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Në nëntë (9)<sup>7</sup> kontrata në vlerë 1,197,677€, menaxherët e kontratave nuk kishin përdorur modulin e e-prokurimit për mbajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit të menaxhimit të kontratave dhe për vlerësimin e performancës së kontraktuesve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme të menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre, për përdorimin e modulit përkatës në sistemin e e-prokurimi.

##### Ndikimi

Mos përdorimi i modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës ndikon në menaxhim jo të plotë dhe jo transparent të kontratave, si dhe kufizon mundësinë që menaxhmenti të ketë informata të sakta dhe në kohë lidhur me progresin dhe performancën e kontratave.

##### Rekomandimi B15

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 126,445,307€, pasurive jokapitale është 647,577€, si dhe e stoqeve 51,788€.

### Çështja B16 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe mos aplikim i zhvlerësimit për pasuritë në përdorim

#### Gjetja

Rregullorja nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, neni 11, përcakton se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi. Gjithashtu, neni 6 i kësaj rregulloreje kërkon që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet t në sistemin e-pasuria.

Në 13 raste në vlerë totale prej 919,077€, pasuritë e ndërtuara gjatë viteve 2015-2022 vazhdonin të figuronin si investime në vijim, ndonëse ishin në përdorim nga Komuna. Për këto pasuri nuk ishte realizuar pranimit teknik dhe nuk ishin transferuar në kategorinë e pasurive në përdorim, rrjedhimisht nuk ishte aplikuar zhvlerësimi.

Për më tepër, Komuna nuk kishte përdorur sistemin e-pasuria për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive nën 1,000€, por i kishte evidentuar ato në një bazë të dhënash në format Excel, për të cilat nuk aplikoheshin zhvlerësimi.

Në mungesë të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet vlera e saktë e zhvlerësimit të munguar, përkatësisht ndikimi i plotë në vlerën e pasurive të prezantuara në PVF.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të mjaftueshme dhe monitorimit për përfundimin me kohë të pranimit teknik dhe regjistrimin e pasurive, si dhe mungesës së veprimeve për funksionalizimin e sistemit e-pasuria.

#### Ndikimi

Mbajtja e pasurive në përdorim si investime në vijim, si dhe mos përdorimi i sistemit e-pasuria, kanë ndikuar në mosaplikim të zhvlerësimit dhe në raportim jo të saktë të pasurive në PVF.

#### Rekomandimi B16

Kryetari duhet të sigurojë realizimin me kohë të pranimit teknik për projektet e përfunduara dhe transferimin e tyre nga investime në vijim në pasuri në përdorim, në mënyrë që të mundësohet aplikimi i zhvlerësimit në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe të sigurojë përdorimin e sistemeve përkatëse për regjistrimin e pasurive.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.5 Të arkëtueshmet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2025, Komuna e Malishevës ka paraqitur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,169,912€, të përbëra nga tatimi në pronë në vlerë prej 3,258,376€, taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë prej 1,721,188€, si dhe qiratë nga shfrytëzimi i pronës komunale në vlerë prej 190,348€.

#### Çështja B17 - Dobësi në menaxhimin dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna ka kompetencë për mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore. Ndërsa sipas nenit 27 të këtij ligji, në rast të mos pagesës së detyrimeve, komuna është e obliguar të ndërmarrë veprime përmes njoftimeve përfundimtare dhe procedurave përkatëse ligjore për arkëtimin e tyre.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 ishin 6,114,760€, duke shënuar rritje prej 26%, krahasuar me vitin 2024. Rritja është evidentuar kryesisht tek tatimi në pronë dhe tek taksa komunale.

Në 41 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë prej 400,362€, si dhe në 19 raste të taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste në vlerë prej 164,955€, komuna nuk kishte ndërmarrë masa ligjore përmes përmbauesve për arkëtimin e këtyre borxheve, edhe pse janë tejkaluar afatet.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme, përfshirë edhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore, si dhe mungesës së politikave konkrete nga ana e komunës për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

##### Ndikimi

Mos arkëtimi me kohë i të arkëtueshmeve ndikon në inkasim më të ulët, të të hyrave vetanake, duke kufizuar kapacitetin financiar të Komunës për financimin e projekteve dhe realizimin e objektivave të saj.

##### Rekomandimi B17

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për menaxhimin dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke ndërmarrë veprime të rregullta për ndjekjen e borxheve dhe duke shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me një staf prej tre anëtarësh: drejtori i NjAB-së dhe dy auditorë. Për vitin 2025, NjAB kishte planifikuar realizimin e shtatë (7) auditimeve, të cilat janë përmbyllur gjatë vitit në fushat si: menaxhimi i pasurisë, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, vlerësimi i ligjshmërisë dhe menaxhimit në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, kulturës, Inspektoratit, financave dhe prokurimit. Si rezultat i këtyre auditimeve, janë dhënë gjithsej 23 rekomandime. Deri në fund të vitit, 10 prej tyre janë zbatuar, 8 janë në proces të zbatimit, ndërsa 5 mbeten të pazbatuara. Komuna ka themeluar Komitetin e Auditimit, mirëpo gjatë vitit 2025 ky komitet nuk ka mbajtur asnjë takim.

#### Çështja B18 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

##### Gjetja

Udhëzuesi Administrativ për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik nr. MF-Nr. 01/2019, neni 6, paragrafi 2, Komiteti i Auditimit ka mandat tre (3) vjeçar, me mundësinë e riemërimit, por jo më shumë se për dy (2) mandate të njëpasnjëshme.

Gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte siguruar vazhdimësinë e funksionimit të Komitetit të Auditimit, pasi nuk kishte rinovuar mandatin e anëtarëve ekzistues dhe as nuk kishte emëruar anëtarë të rinj me kohë, pas përfundimit të mandatit. Si rrjedhojë, Komiteti i Auditimit nuk ka qenë funksional gjatë vitit 2025, ndërsa emërimi i anëtarëve të rinj është bërë me vonesë prej një viti.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesë së vëmendjes dhe planifikimit për rinovimin e mandateve dhe emërimin me kohë të anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

##### Ndikimi

Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit ndikon në dobësim të mbikëqyrjes së funksionit të auditimit të brendshëm dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe kufizon mbështetjen ndaj menaxhmentit në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit financiar.

##### Rekomandimi B18

Kryetari duhet të sigurojë vazhdimësi në funksionimin e Komitetit të Auditimit përmes rinovimit me kohë të mandateve ose emërimit të anëtarëve të rinj para skadimit të tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

#### Çështja 1 **Mos pajtueshmëritë lidhur me deklaratimet në Raportin Vjetor Financiar.**

##### Gjetja

Në Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të Komunës së Malishevës kemi identifikuar mos-pajtueshmëri në deklarime si në vijim:

1. Neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme-shumat e pranimeve nga granti qeveritar, të hyrat vetanake dhe grantet e përcaktuara të donatorëve, të paraqitura tek burimet e fondeve, si dhe shuma e mallrave dhe shërbime dhe shpenzimeve komunale tek shifrat krahasuese (viti 2023) të paraqitura tek shfrytëzimi i fondeve, nuk ishin paraqitur saktë;
2. Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - Shuma e buxhetit final tek grantet e përcaktuara të donatorëve dhe shuma e të hyrave tjera të paraqitura tek hyrja e parasë së gatshme, si dhe shuma e mallrave dhe shërbime dhe shpenzimeve komunale tek shifrat krahasuese (viti 2023) nuk ishin paraqitur saktë;
3. Shpalosjet- Shumat e shpenzuar gjatë vitit aktual e paraqitur tek neni 21 (të hyrat vetanake të pa shpenzuara) si dhe shumat e detajeve të llogarive të arkëtueshme të paraqitura tek neni 16 (llogaritë e arkëtueshme) nuk ishin të sakta.

##### Veprimi i kërkuar

Komunës i është kërkuar të bëjë korrigjimet e nevojshme në Raportin Vjetor Financiar me qëllim të sigurimit të paraqitjes së saktë dhe të plotë të informacionit financiar.

##### Rezultati

Komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korrigjuar mos-pajtueshmëritë e identifikuara, në përputhje me kërkesat rregullatore. Megjithatë, komuna duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontroleve të brendshme në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të raporteve financiare, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së çështjeve të ngjashme në të ardhmen. Në rast të përsëritjes, çështja do të trajtohet si gjetje me rekomandim përkatës.

### 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>a</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>21,576,545</b>	<b>23,072,878</b>	<b>22,862,385</b>	<b>21,618,284</b>	<b>20,008,369</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	20,071,019	20,901,036	20,743,803	19,399,450	17,967,299
Të bartura nga viti i kaluar	0	338,744	335,927	188,564	285,526
Të hyrat vetanake	1,505,526	1,505,526	1,456,225	2,030,271	1,755,544
Donacionet vendore	0	508	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	327,064	326,430	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,496,333€. Kjo rritje është rezultat i mjeteve shtesë nga granti qeveritar prej 830,017€, të hyrave vetanake si rezultat i tejkalimi të planit të hyrave 1,141,860€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 338,744€ dhe donacioneve 327,572€.

Në vitin 2025 Komuna e Malishevës ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar, me një rritje në realizim të buxhetit prej 1% krahasuar me vitin 2024, ku realizimi ishte 98%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>21,576,545</b>	<b>23,072,878</b>	<b>22,862,385</b>	<b>21,618,284</b>	<b>20,008,369</b>
Pagat dhe mëditjet	11,713,202	12,543,236	12,474,149	11,734,980	10,610,631
Mallrat dhe shërbimet	2,600,200	2,603,358	2,539,332	1,924,973	2,045,641
Komunalitë	600,000	600,000	578,156	645,999	514,406
Subvencionet dhe transferet	600,000	600,000	553,066	479,249	699,266
Investimet Kapitale	6,063,143	6,726,284	6,717,680	6,833,084	6,138,425

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 830,034€. Kjo rritje vjen kryesisht për mbulimin e obligimeve që kanë rrjedh nga kontrata kolektive. Realizimi i kësaj kategorie ishte 99%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 3,358€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat bartjes së të hyrave vetanake për mbulimin e nevojave të komunës për shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%.
- Buxheti i komunalive nuk kishte ndryshime, derisa realizimi në fund të vitit ishte 98%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere nuk kishte ndryshime, derisa realizimi në fund të vitit ishte 92%.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 663,141€. Kjo rritje ishte për financimin e projekteve kapitale që do përmirësojnë infrastrukturën e komunës. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 100%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2025 ishin në vlerë prej 1,984,815€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. Për vitin 2025, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 1,505.526€, duke tejkuluar planin e të hyrave të planifikuara je në realizim për 479,289€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, ka rritje prej 91,791€, që kryesisht i përket të hyrave të tatimit në prone taksa për leje të ndërtimit dhe leje mjedisore.

Në shumën totale të pranimeve për vitin 2025, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 268,527€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), e të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,505,526</b>	<b>1,505,526</b>	<b>1,984,815</b>	<b>1,893,024</b>	<b>1,589,969</b>
Të hyrat tatimore	410,138	410,138	704,848	748,261	638,815
Të hyrat jo tatimore	1,095,388	1,095,388	1,270,171	1,143,350	949,377
Të hyrat tjera	0	0	9,796	1,412	1,777

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2024 të Komunës së Malishevës ka rezultuar me 24 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, pesë rekomandime janë zbatuar një ishte në proces dhe 18 rekomandime nuk janë zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë regjistra të saktë, si dhe ruajnë dhe mirëmbajnë dokumentacionin burimor në përputhje me kërkesat ligjore për llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PVF.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në raportimin e drejtë të pasurive në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim

4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë përforsimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet që para inicimit të procedurave të prokurimit për projektet kapitale, për të njëjtat ka fonde të mjaftueshme buxhetore të parapara në ligjin e buxhetit dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhen vetëm në rastet kur përfitimi i komunës është i qartë, derisa shërbimet të kontrahohen duke i zbatuar procedurat e prokurimit publik.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive tek njësit kërkuese dhe zyrën e prokurimit, ashtu që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj përmes njësite kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të kontratave nga ana e menaxherëve të kontratave.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që pozitat e rregullta të punës të mbulohen me punonjës të rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit të kërkuara me rregullat përkatëse. Derisa, angazhimet për shërbime të veçanta të bëhen vetëm atëherë kur nevojat e drejtorive nuk mund të plotësohen nga stafi aktual i të punësuarve brenda komunës.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi

12.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme në aplikimin e tarifave me rastin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, duke respektuar normat e përcaktuara me rregulloren komunale, në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti dhe objektivat e komunës.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit në procesin e vlerësimit të tenderëve, me qëllim që vlerësimi i ofertave të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
15.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kompensimet për funksione shtesë të zyrtarëve të komunës, bëhen vetëm në rastet kur të njëjtët kryejnë detyra të cilat i plotësojnë kriteret e rregullores përkatëse për funksione shtesë.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
16.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se Drejtoria e Urbanizmit i ka të vendosur të gjithë mekanizmat e nevojshëm për vlerësimin dhe shqyrtimin e lejeve mjedisore në përputhje me rregullat përkatëse.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
17.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e limiteve me rastin e subvencionimit, derisa në rastet e përkrahjeve mbi 1,000€, të merret aprovimi dhe vendimi i Kuvendit Komunal, bazuar në kërkesat e rregullores së brendshme për subvencionim.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar

18.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit..	Nuk ka filluar zbatimin
20.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha procedurat e rekrutimit të zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në mënyrë që të sigurohet ligjshmëria e procesit.	Përkundër disa veprimeve të cilat i ka marrë komuna për përmirësim të kësaj çështje, gjatë vitit 2025 ka rezultuar pjesërisht kjo çështje.	Pjesërisht i zbatuar
21.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Për zyrtarët të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet, duhet të sigurojë ndalesën përmes sistemit të pagave.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
22.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se janë buxhetuar fonde të mjaftueshme për të gjitha projektet sipas dinamikës së paraparë me kontratë, në mënyrë që të shmangen vonesat në realizim të këtyre projekteve.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
23.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurohet që të funksionalizoj sistemin e pasurisë me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga ligjet në fuqi dhe sigurisë së informatave.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
24.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, Komiteti duhet të monitoroj veprimet e ndërmarrura nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



PRAHUR MË: 26/05/2026  
ACCEPTED ON:  
PRILJENO: 01/855  
Mr. No. B:



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raportit");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit të cilat ja bashkangjesim kësaj shkrese; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës  
Komuna e Malishevës  
Malishevë, 25.05.2026



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>10</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Specifikacion 129,258€, Tektoniks LLC27,027€
- <sup>6</sup> Rrugët lokale 150,000€ Rrugë lokale 50,775€ Rrugët lokale 31,605€ Rrugët lokale 25,000€ Paisje mjekësore 19,989€ Rrugët lokale 133,447€ Rrugë lokale 100,000€ Rrugë lokale 47,466€ Rrugët lokale 30,000€ Parqet dhe hapsirat publike 29,742€ Parqet dhe hapsirat publike 28,128€ Ndërtesat arsimore 26,315€ Ndërtesat arsimore 25,075€ Objekte sportive 20,967€ Rrjet kanalizimi 20,000€ Rrjet kanalizimi 20,000€ Objekte sportive 18,713€ Rrjet kanalizimi 14,911€, Rrugët lokale 13,079€.
- <sup>7</sup> Rrënim i ndërtimeve pa leje ndërtimore në territorin e k.malishevë 150,000€ Ndërtimi i rrugës tek ujëvara e mirushës komuna malishevë 546,164€ Renovimi i objekteve të institucioneve arsimore në komunën e malishevës 259,492€ Ndërtimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit të lumit me strukturën përcjellëse nga ura në qendër deri tek tranziti në malishevë (aneks) 146,450€
- <sup>8</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>9</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>10</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.